




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.981/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina -Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik: “PLAN-a Consultin & Geo & Land & Globi Consulting” –Prishtinë kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” shpk-Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Punimi i Hartës Zonale Komunale”, me nr. të prokurimit: 632-19-4699-4-1-3, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Gjakovës, më datën: 04.02.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e grupit të operatorëve ekonomik “PLAN-a Consultin & Geo & Land & Globi Consulting” –Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Punimi i Hartës Zonale Komunale”, me nr. të prokurimit: 632-19-4699-4-1-3, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Gjakovës.

II. VËRTETOHET, njoftimi i autoritetit kontraktues për dhënie të kontratës i datës: 18.12.2019, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Punimi i Hartës Zonale Komunale”, me nr. të prokurimit: 632-19-4699-4-1-3, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Gjakovës.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e grupit të operatorëve ekonomik “PLAN-a Consultin & Geo & Land & Globi Consulting” –Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Sqarim rreth iniciave për procesin e prokurimit :

Autoriteti kontraktues në tekstin e më poshtëm AK ;

Operatori ekonomik në tekstin e më poshtëm OE ;

Dosja e Tenderit në tekstin e më poshtëm DT ;

Njoftimi për Kontratë në tekstin e më poshtëm NJpK ;

Ligji për Prokurim Publik-në tekstin e më poshtëm LPP;

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publiken tekstin e më poshtëm- RRUOPP

Organi Shqyrtues i Prokurimit në tekstin e më poshtëm –OSHP;

Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik në tekstin e më poshtëm -KRPP

Kriteri për dhënien e kontratës; Propozimi financiar do të vlerësohet me 20% dhe propozimi teknik do të vlerësohet me 80%.

Konkurs projektimi vlera e parashikuar e kontratës 200.000,00€

Afati i fundit për pranimin e tenderëve ka qenë data 13.08.2019

Data e njoftimit për kontratë është bërë me datë 18.12.2019

Operatori ekonomik ankues “PLAN-a Consultin & Geo & Land & Globi Consulting” –Prishtinë si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 31.12.2019 me nr. 981/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Punimi i Hartës Zonale Komunale”, me nr. të prokurimit: 632-19-4699-4-1-3, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Gjakovës, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7, 52, 58, 60, të Ligjit për

Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 57 të RrUOPP, dhe Dosja e konkursit të projektimit pika 18.1 dhe 18.2 dhe Ligji i Planifikimit hapësinor.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 14.01.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt:24.01.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim: Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 78 të LPP-së (Njoftimi mbi rezultatet e konkursit të projektimit) sepse nuk jemi njoftuar me rezultatet e komisionit për propozim teknik si dhe nuk është bërë hapja publike e ofertave (propozimi teknik dhe oferta financiare) edhe pse në faqen 16 të dosje ekziston përshkrimi “data e hapjes së ofertave financiare dhe identifikimit të OE do të caktohet në njoftimin për rezultatin e konkursit të projektimit”, eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Neni 78 i LPP-së nuk parasheh që të publikohen rezultatet e propozimit teknik të konkursit. Neni 57.28 dhe 57.29 i RRUOPP parasheh që pikët për propozimet ideore të projekteve në bazë të kriterëve teknike të përcaktuara në dosjen e konkursit të projektit duhet të mbeten konfidenciale nga anëtarët e jurisë. Në këtë mënyrë ka vepruar edhe autoriteti kontraktues. Ndërsa në përputhje me nenin 78 të LPP-së dhe përshkrimin të faqes 16 të dosjes së konkursit të projektimit, me rastin e publikimit të rezultatit të konkursit të projektimit është prezantuar edhe çmimi i ofertës financiare. Në formularin Standard B58-Njoftimi mbi vendimin e AK është prezantuar çmimi i ofertës financiare si rezultat i konkursit të projektimit. Këtu ka një lëshim nga AK, që duket të jetë teknik sepse është dashur të shkruhen edhe numri i pikëve totale të secilës ofertë. Mirëpo ky lëshim teknik i AK-së nuk e ka dëmtuar OE ankues sepse oferta e tij ka pikë më pakë se oferta e rekomanduar për kontratë.

Sipas kriterëve të dosjes së konkursit të projektimit për dhënien e kontratës (80 pikë propozimi teknik dhe 20 pikë oferta financiare), OE ankues ka gjithsej 90.4 pikë, ndërsa oferta e OE të rekomanduar për kontratë ka gjithsej 96.2 pikë. Këto rezultate janë të publikuar në raportin e vlerësimit të ofertave që është i ngarkuar në platformën elektronike të KRPP-së. Prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Pretendimi se është shkele neni 80.2 sepse kompania fituese e ka identifikuar vetveten sepse ka marrë si

shembull të zonimit hartën e Suharekës të cilën e ka punuar vetë, eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Secili OE ekonomik e njuhë ofertën e vet, mirëpo operatorët e tjerë nuk e dinë për ofertat e OE konkurent. Propozimet teknike mbahen vetëm nga Juria profesionale që bënë vlerësimin teknik dhe në fund të vlerësimit i rendit me një tabelë pikët e vlerësimit teknik të secilës ofertë. E rëndësishme është që anëtarët e jurisë të bëjnë vlerësimin teknik vetëm me shifrën e kandidatit pa emrin e OE. Në këtë formë ju janë dhënë jurisë propozimet teknike vetëm me shifrën e kandidatit. Prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Pretendimi i fundit i OE ankues se komisioni i vlerësimit ka shkele nenin 6 të LPP-së (ekonomiciteti dhe efikasiteti) sepse i referohet i referohet çmimit më të ulët dhe po ashtu ka diskriminim në vlerësim dhe kundërthënës në raport me ofertën tonë dhe mangësitë në ofertën teknike të OE fitues, të cilat OE ankues i përmendë disa mangësi të OE fitues, eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Nuk ka shkelje të nenit të 6 të LPP-së sepse vlerësimi i ofertave është bërë në bazë të kriterëve të konkursit të projektimit, raportit 80/20 pikë të propozimit teknik dhe financiar. E përmendëm edhe më lartë se referimi i AK në njoftimin e vendimit ta AK-se për rezultatin e konkursit vetëm në çmimin më të ulët pa i përmend edhe pikët e secilës oferta ka qenë një lëshim teknik. Përndryshe pikët e ofertave janë të publikuar në raportin e vlerësimit të ofertave që është i ngarkuar në platformën elektronike. Nuk është dëmtuar asgjë OE ankues me këtë veprim të AK-se. Ndërsa sa i përket mangësive të ofertës teknike të OE të rekomanduar për kontratë që i përmend OE ankues, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Propozimet teknike të ofertave i vlerëson vetëm juria profesionale e caktuar nga AK dhe askush tjetër. Ata i bëjnë vlerësimet teknike të secilës ofertë sipas pikëve. Në bazë të nenit 57 të RRUOP askush tjetër nuk duhet ti shohë dhe vlerësoj propozimet teknike të kandidatëve përveç anëtarëve të jurisë. Sepse ato janë vlerësime janë tërësisht profesionale të secilit anëtarë të jurisë dhe në fund juria jep një listë me radhitjen e kandidatëve sipas numrit më të madh të pikëve. Kjo listë i dorëzohet zyrtarit të prokurimit. Këto propozime teknike duhet të mbesin konfidenciale. Propozimi teknik i OE fitues nga Juria ka marrë 100 pikë ndërsa propozimi teknik i OE ankues nga juria ka marrë 88 pikë. D.m.th është e renditur e dyta për nga oferta teknike. Këto kanë qenë vlerësimet e anëtarëve të jurisë. Secila ofertë mundet të ketë dobësi dhe merita. Mirëpo vlerësimi i jurisë është përfundimtar dhe nuk mundet të rivlerësohet propozimi teknik. Prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Mendimi i ekspertit profesional.

Autoriteti kontraktues ka bërë vlerësimin e ofertave sipas kritereve të dhëna në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë për konkurs të projektimit. Oferta e OE të rekomanduar për kontratë ka marrë më së shumti pikë në vlerësimin teknik dhe ky rezultat ka ndikuar edhe në rezultatin përfundimtar të shpalljes së fituesit të konkursit të projektimit. Komisioni i vlerësimit të ofertave në përgjithësi ka respektuar dispozitat e LPP-së gjatë këtij procesi. Nuk ka pasur shkelje të neneve të LPP-se të përmendura në ankesë, të cilat e dëmtojnë procesin e prokurimit në këtë aktivitet edhe pse procedura në konkurse të projektimit është pakë me komplekse se proceduar e prokurimit për aktivitete të tjera. Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar.

Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që të vazhdojnë dhënien e kontratës për aktivitetin e prokurimit “Punimi i Hartës Zonale Komunale” me nr. prok. 632-19-4699-413 në bazë të dispozitve të LPP-së.

Operatori Ekonomik, me datë: 26.01.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, së nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes parashtresës me shkrim të datës: 24.01.2020, ka njoftuar, Autoriteti Kontraktues, lidhur me mendimin e ekspertit edhe pse shkresat i kanë pranuar me kohë i njëjti nuk është përgjigjur.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 04.02.2020, ku kanë qenë prezent të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesi i OE-së ankues, ndërsa përfaqësuesit e AK-së nuk janë prezent në seance, të njëjtit janë njoftuar në mënyrë të rregullt për mbajtjen e seancës, të njëjtit nuk kanë njoftuar me arsyen e mos prezencës se tyre në këtë seance, në seancë është edhe eksperti shqyrtues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e OE-së ankues z. Kelmendi deklaroj: Nuk pajtohem me asnjë nga përgjigjet e ekspertit shqyrtues. Jemi befasuar që ka trajtuar lenden eksperti që nuk është i lëmise, duke

ditur qe te tille te tille ka ne listën tuaj e te eksperteve. Planifikimi hapësinor është fushe specifike dhe kërkon ekspertize relevante, ne mënyre qe te vlerësohet si duhet. Ne lidhje me shkeljet procedurale ligjore, argumentet tona janë: E kontestojmë mendimin e ekspertit shqyrtues qe nuk ka pasur shkelje te procedurave te njoftimit te vlerësimit. Sipas nenit 57.30 të Rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik, pasi që Zyrtaari i Prokurimit pranon listën e radhitjes së projekteve (nga juria), Zyrtari i Prokurimit, duhet që të përgatitë Formularin B58 “Njoftimin mbi vendimin e AK” dhe ta ngrite ne platforme te prokurimit elektronik. Kjo listë e vlerësimit teknik nga juria nuk është publikuar, por vetëm lista e çmimeve (ofertës financiare). Ne lidhje me njoftimin e datës 18.12.2019 për vendimin e përzgjedhjes, AK nuk është konsistent në mënyrën e vlerësimit dhe njoftimit për vlerësim, në FDT specifikohet se vlerësimi do të bëhet sipas kriterëve teknike dhe financiare (qe nënkupton tenderin ekonomikisht me te favorshëm), kurse ne njoftim te vendimit i referohet çmimit më të ulët.

Nuk pajtohem me mendimin e ekspertit i cili thotë qe është një lëshim nga AK qe duket te jete gabim teknik, e njëjta përgjigje përsëritet edhe ne vendimin ne kërkesën për rishqyrtim të datës 26.12.2019. Me këtë është shkelur nenit 52 dhe 60 i LPP-së. Nuk pajtohem me mendimin e ekspertit qe nuk ka pasur shkelje te kriterëve te konkursit meqenëse, meqenëse ne raportin e vlerësimit është prezantuar vetëm numri i pikëve përfundimtare dhe jo pikët për secilin nga 5 nen-kriteret.

Me këtë është shkelur neni 80, paragrafi 3, si dhe neni 52, paragrafi 3, sipas të cilave “Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim”, si dhe neni 23.1 i FDT-se. Kjo është vërejtur vetëm pasi na është mundësuar qasja në dokumente të vlerësimit teknik. Është shkelur LPP, neni 80, paragrafi 2, sepse është shpallur fitues kompania e cila ka identifikuar vetveten në konkurs projektimi. Operatori fitues ne propozim teknik ka marre si shembull te zonimit hartën e komunës se Suharekës si dhe projektet nga plani i veprimit të PZHK-se se Ferizajt, e cila është e punuar nga vet operatori duke bere kështu te identifikueshëm vetveten. Te njëjtat dokumente janë bere publik nga vete operatori ekonomik ne faqen e tij ne internet. Komuniteti i arkitekteve dhe urbanistëve është i vogël dhe çdo plan qe hartohet është i qasshëm për publikun. Përgjigja e ekspertit qe ky pretendim është i pabaze nuk qëndron dhe nuk përkon fare me pretendimin, me gjase nuk është kuptuar nga shqyrtuesi. Është e vërtete qe anëtarët e jurisë bëjnë vlerësimin teknik me shifrën e kandidatit, mirëpo fakti qe OE fitues e ka dhëne shembull punën e tij e benë të identifikueshem. Përgjigja e ekspertit shqyrtues qe secila oferte mund te këtë dobësi dhe merita; vlerësimi i jurisë është përfundimtar dhe nuk mund te rivlerësohet propozimi është e pabaze. Konsiderojmë qe objekt i ankesës se konkursit janë jo vetëm aspekti procedural, por edhe ai teknik, i cili ka pasur peshën me te madhe vlerësuese (80 me 20). Vlerësimi adekuat teknik është thelbësor, sepse prej ti varet kualiteti i dokumentit te Hartës Zonale dhe e ardhmja e komunës te Gjakovës. (veç një ilustrim, rasti i Badovcit, ose rasti i Ferizajt, i cili ka një problem te madh për shkak te një dokumenti te tille te punuar dobët, ku parashihet zgjerimi i qytetit për 1 milion e 200.000 banore). Befasuese është poentimi me 100 pike, dmth maksimumi nga secili anëtar për secilin kriter, duke pas parasysh qe Operatori fitues nuk plotëson kriterin

e detyrueshëm te FDT-se (Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME), duke mos ofruar trajnime për përdorim te GIS-it dhe për hartim dhe zbatim te Hartës Zonale. Operatori ekonomik fitues përdor standarde/definicione te cilat nuk janë në përputhje me UA MMPH Nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor. OE fitues përdor standarde të kopjuara nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë, konkretisht nga Vendimi Nr.481, datë 22.6.2011, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 24 të ligjit nr.10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”. Ne propozimin tek te Operatorit fitues deklarohet qe kompania ne fjale ka qasje ne shume harta te domosdoshme për përgatitjen e PZHK-se dhe HZK-se. Kjo deklarate është çorientuese pasi te dhënat e radhitura janë te dhëna ne pronësi te MMPH-se, e jo te kompanisë private. Gjithashtu, janë ofruar harta te përgatitura qe paraqesin propozimet e zhvillimeve te ardhshme (si psh harta e zoonimit), qe do te duhej te ishin rezultat i dokumentit, punës se ardhshme te operatorit pas dhënies se kontratës. Kështu e vënë në lajthitje ekipin vlerësues me ofrimin e hartave të përgatitura për PZHK dhe HZK, e që nuk janë subjekt i propozimit teknik e as kërkesë se dosjes se tenderit. Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet ka vepruar në kundërshtim me nenin 6 të LPP-se, paragrafi 1 :” 1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.”, duke u nisur nga fakti që në njoftimin për dhënien e kontratës AK i referohet çmimit më të ulët.

Komuna e Gjakovës e shpërblen Operatorin Ekonomik oferta e te cilit është 199.800,00€, më e shtrenjtë për 39.100,00€ sesa oferta e Konzorciumit tone me udhëheqës Plan-A Consulting, e cila është më e lira nga 4 ofertuesit. Me këtë procedure do të dëmtohej buxheti i taksapaguesve të komunës për 39.100,00€ dhe kualiteti i dokumentit do te jete i diskutueshëm.Në lidhje me afatet e njoftimit, konsiderojmë që AK ka shkelur nenin 21 të Rregullores së PP, sipas të cilit AK ka për detyrë të përfundojë vlerësimin dhe të vendose njoftimin për rezultate ne platformë elektronike brenda 30 ditësh, plus 20 dite në raste te jashtëzakonshme. Kjo procedure ka kaluar këtë afat, duke zgjatur 98 dite nga mbyllja e tenderit me 13. Gusht 2019 deri me 19 nëntor 2019, kur është shpallur procesverbali i hapjes se ofertës financiare. Diskriminim në vlerësim dhe kundërtënës .1. AK ka shkelur LPP, nenin 7 dhe nenin 52, sepse në Raportin e vlerësimit të tenderëve- paragrafi I deklaratës në lidhje me vlerësimin e Konzorciumit tonë thuhet (citim):

“Kësaj firme konkurrese në raport me firmën fituese I mungon përshkrimi edhe MË i detajuar i të gjitha aktiviteteve të prezantuara, andaj e njëjta është vlerësuar e renditur si e dyta”.

Këtë përshkrim e konsiderojmë Diskriminues në raport me krahasimin me firmën fituese e jo me kriteret e dhëna në Dosjen e tenderit (shkelje e nenit 80 të Ligjit për Prokurim Publik). Kjo është në kundërtënie

edhe me kërkesën e njërit nga nën kriteret e vlerësimit, të paraqitur në dosjen e tenderit, sipas të cilit kërkohet përshkrim të shkurtë i hapave kyç të metodologjisë. Nga ana tjetër e konsiderojmë Kundërthënës sepse në paragrafin e mësipërm thuhet se “Konzorciumi ynë (me shifër B007) ka prezantuar në mënyrë shumë të qartë vijueshmërinë e të gjitha aktiviteteve konform detyrës së dhënë me konkurs. Dokumenti I prezantuar në mënyrë të renditur konform obligimeve ligjore sipas prioriteteve duke filluar nga faza e parë deri te ajo përfundimtare. Është bërë elaborim I metodologjisë për hartim të PZHK-së dhe HZK-së në mënyrë të mirëfilltë të planifikimit nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të gjithë akterëve”. Operatori fitues ne propozimin e vet teknik shkel 2 here nenin 28 të Ligjin aktual te planifikimit 04/L-174, (sipas te cilit shfuqizohet ligji i vjetër i planifikimit L-2003/14) duke deklaruar 2 here qe hartimi i PZHK-se dhe HZK-se do te behet ne baze të Ligjit L2003/14, i cili me nuk është ne fuqi qe nga shtatori i vitit 2013, dhe nuk guxon te punohet sipas tij. 2. Ne propozimin teknik te operatorit fitues nuk ofrohet propozimi autentik dhe i shkurte siç kërkohet ne kriteret e dosjes se tenderit (nënkriteri i trete) , neni 23.1 i FDT-se), për te ju qasur procesit te hartimit te HZK se Gjakovës por, kryesisht duke kopjuar UA 24/2015 për Harte Zonale të Komunës, ofrohet material i gjere dhe voluminoz i cili për fat te keq është vlerësuar për nga kuantiteti e jo kualiteti.

3. Për me tepër operatori fitues ne propozimin teknik ofron tekst në gjuhen angleze të pa referencuar si dhe ikona dhe legjenda qe nuk janë ne përputhje me UA të Normave Teknike te Planifikimit Hapësinor. Besojmë qe arsyetimet qe i dhamë janë mjaftueshëm argumentuese për te vërtetuar qe ankesa jone ka baze dhe qe autoriteti juaj do te rekomandon rivlerësim te konkursit.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti profesional z. Kurtishaj deklaroi: Jam munduar të jap përgjigje në pretendime, DT ka qenë shume profesionale, kriteret janë dhëne me ligjin kriteret qe kërkohen për konkurs projektimi, pretendimet ankimore te OE ankues nuk janë te bazuara ne rregulla qe parashihen me konkurs Projektimi një nder to thotë rezultatet e prezantimit publik nuk bëhen nga Autoriteti Kontraktues dhe kjo nuk parashihet as me dispoziten nenit 27. Poenat e marruar nga vlerësimi nuk bëhen publike. Vlerësimi teknik i ka marr 100 poena kur është zbërthyer me kriteret ka dal 94%. Mendimi i jurisë është ekip profesionale edhe vlerësimet qe japin ato, ato mbesin konfidenciale dhe nuk mund të këtë një rivlerësim. Hartat zonale të paraqitura për projektin Jezerc ato nuk kanë pasur emër janë në përputhje me rregulloren nuk dihet kush i ka punuar, OE ankues supozon qe janë te tije. Mbes mbrapa mendimit të dhëne ne ekspertize.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Kelmendi deklaroi: Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroi: Kërkojmë nga paneli shqyrtues te aprovoj ankesën tonë si të bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “PLAN-a Consultin & Geo & Land & Globi Consulting” –Prishtinë, se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 78 të LPP-së (Njoftimi mbi rezultatet e konkursit të projektimit) sepse nuk jemi njoftuar me rezultatet e komisionit për propozim teknik si dhe nuk është bërë hapja publike e ofertave (propozimi teknik dhe oferta financiare) edhe pse në faqen 16 të dosjes ekziston përshkrimi “data e hapjes së ofertave financiare dhe identifikimit të OE do të caktohet në njoftimin për rezultatin e konkursit të projektimit”. Paneli Shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës sqaron se Neni 78 i LPP-së nuk parasheh që të publikohen rezultatet e propozimit teknik të konkursit. Neni 57.28 dhe 57.29 i RRUOPP parasheh që pikët për propozimet ideore të projekteve në bazë të kriterëve teknike të përcaktuara në dosjen e konkursit të projektit duhet të mbeten konfidenciale nga anëtarët e jurisë. Në këtë mënyrë ka vepruar edhe autoriteti kontraktues. Ndërsa në përputhje me nenin 78 të LPP-së dhe përshkrimit të faqes 16 të dosjes së konkursit të projektimit, me rastin e publikimit të rezultatit të konkursit të projektimit është prezantuar edhe çmimi i ofertës financiare. Në formularin Standard B58-Njoftimi mbi vendimin e AK është prezantuar çmimi i ofertës financiare si rezultat i konkursit të projektimit. Andaj këtu ka një lëshim nga ana e AK, që duket të jetë teknik sepse është dashur të shkruhen edhe numri i pikëve totale të secilës ofertë. Mirëpo ky lëshim teknik i AK-së nuk e ka dëmtuar OE ankues sepse oferta e tije ka pikë më pakë se oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë. Sipas kriterëve të dosjes së konkursit të projektimit për dhënien e kontratës (80 pikë propozimi teknik dhe 20 pikë oferta financiare), OE ankues ka gjithsej 90.4 pikë, ndërsa oferta e OE të rekomanduar për kontratë ka gjithsej 96.2 pikë. Këto rezultate janë të publikuar në raportin e vlerësimit të ofertave që është i ngarkuar në platformën elektronike të KRPP-së. Andaj, ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “PLAN-a Consultin & Geo & Land & Globi Consulting” –Prishtinë se është shkel neni 80.2 sepse kompania fituese e ka identifikuar vetveten sepse ka marrë si shembull të zonimit hartën e Suharekës të cilën e ka punuar vetë. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se secili OE ekonomik e njej ofertën e vet, mirëpo operatorët e tjerë nuk e dinë për ofertat e OE konkurent. Propozimet teknike mbahen vetëm nga Juria profesionale që bënë vlerësimin teknik dhe në fund të vlerësimit i rendit me një tabelë pikët e vlerësimit teknik të secilës ofertë. E rëndësishme është që anëtarët e jurisë të bëjnë vlerësimin teknik vetëm me shifrën e kandidatit pa emrin e

OE. Në këtë formë ju janë dhënë jurisë propozimet teknike vetëm me shifrën e kandidatit. Prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “PLAN-a Consultin & Geo & Land & Globi Consulting” –Prishtinë se komisioni i vlerësimit ka shkel nenin 6 të LPP-së (ekonomiciteti dhe efikasiteti) sepse i referohet çmimit më të ulët, dhe po ashtu ka diskriminim në vlerësim dhe kundërthënës në raport me ofertën tonë dhe mangësitë në ofertën teknike të OE fitues, të cilat OE ankues i përmendë disa mangësi të OE fitues. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se gjatë këtij aktiviteti të prokurimi nuk ka shkelje të nenit të 6 të LPP-së për faktin se vlerësimi i ofertave është bërë në bazë të kriterëve të konkursit të projektimit, raportit 80/20 pikë të propozimit teknik dhe financiar. E përmendëm edhe më lartë se referimi i AK në njoftimin e vendimit ta AK-se për rezultatin e konkursit vetëm në çmimin më të ulët pa i përmend edhe pikët e secilës oferta ka qenë një lëshim teknik. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se pikët e ofertave janë të publikuar në raportin e vlerësimit të ofertave që është i ngarkuar në platformën elektronike. Nuk është dëmtuar asgjë OE ankues me këtë veprim të AK-së. Ndërsa sa i përket mangësive të ofertës teknike të OE të rekomanduar për kontratë që i përmend OE ankues, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se propozimet teknike të ofertave i vlerëson vetëm juria profesionale e caktuar nga AK dhe askush tjetër. Ata i bëjnë vlerësimet teknike të secilës ofertë sipas pikëve. Në bazë të nenit 57 të RRUOP askush tjetër nuk duhet ti shohë dhe vlerësoj propozimet teknike të kandidatëve përveç anëtarëve të jurisë. Sepse ato janë vlerësime janë tërësisht profesionale të secilit anëtarë të jurisë dhe në fund juria jep një listë me radhitjen e kandidatëve sipas numrit më të madh të pikëve. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se kjo listë i dorëzohet zyrtarit të prokurimit. Këto propozime teknike duhet të mbesin konfidenciale. Propozimi teknik i OE fitues nga Juria ka marrë 100 pikë ndërsa propozimi teknik i OE ankues nga juria ka marrë 88 pikë. D.m.th është e renditur e dyta për nga oferta teknike. Këto kanë qenë vlerësimet e anëtarëve të jurisë. Secila ofertë mundet të ketë dobësi dhe merita. Mirëpo vlerësimi i jurisë është përfundimtar dhe nuk mundet të rivlerësohet propozimi teknik. Prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se Autoriteti kontraktues ka bërë vlerësimin e ofertave sipas kriterëve të dhëna në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë për konkurs të projektimit. Oferta e OE të rekomanduar për kontratë ka marrë më së shumti pikë në vlerësimin teknik dhe ky rezultat ka ndikuar edhe në rezultatin përfundimtar të shpalljes së fituesit të konkursit të

projektimit. Komisioni i vlerësimit të ofertave në përgjithësi ka respektuar dispozitat e LPP-së gjatë këtij procesi. Nuk ka pasur shkelje të neneve të LPP-së të përmendura në ankesë, të cilat e dëmtojnë procesin e prokurimit në këtë aktivitet edhe pse procedura në konkurse të projektimit është pakë me komplekse se proceduar e prokurimit për aktivitete të tjera.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit si dhe sqarimet e dhëna nga eksperti profesional i prokurimit, vlerëson se autoriteti kontraktues ka vepruar në pajtim me nenin 59 të LPP-së, dhe vlerësimin e ofertave e ka bërë sipas kritereve të dhëna në dosjen tenderit dhe njoftimit për kontratë për konkurs të projektimit. Andaj pretendimet ankimore të ngritura nga operatori ekonomik ankues nuk mbështeten në ndonjë provë apo argument të besueshëm të cilat do të vërtetojnë saktësisht shkeljet e dispozitave të LPP-së nga ana e autoritetit kontraktues.

Po ashtu autoritetet kontraktuese ka vepruar në harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nuhi Paçarizi



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna e Gjakovës

1x1 OE-“PLAN-a Consultin & Geo & Land & Globi Consulting” –Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.